



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Raport për tremujorin e parë 2022

Oda e Mjekëve të Kosovës



Maj 2022

Prishtinë

Përmbajtja:

Raport për tremujorin e parë 2022	1
1. Infrastruktura Juridike	3
2. Këshilli Drejtues.....	4
3. Anëtarësimi	5
4. Mbikëqyrja etiko-profesionale	6
5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional.....	7
6. Licencimet.....	7
7. Edukimi specialistik - zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të	8
8. Këshilli Mbikëqyrës.....	8
9. Komisioni për çështje Etike i OMK-së	8
10. Komisioni për Edukim Specialistik	8
11. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke.....	8
12. Raporti financiar.....	9
12.1 Raporti financiar për periudhën deri me 31 mars 2022.....	9
12.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional	10
12.3 Prokurimi.....	10
13. Aktivitete të tjera	10
13.1 Botimi i Revistës Mjeku.....	10
13.2 Kongresi i tretë të Mjekësisë me temë Pandemia COVID-19, Sfidat dhe Përvojat. 11	
13.3 Obelisk kushtuar punëtorëve shëndetësor	11
13.4 Tryeza e rrumbullakët - “Gjendja aktuale në sektorin e shëndetësisë – Kemi apo nuk kemi sistem shëndetësor funksional? Kahja e reformës së nevojshme”	12
13.5 Marrëveshja për bashkëfinancimin e projektit të profilizimit të mjekëve - trajnimeve për stafin e Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit	13
13.6 Grupi punues për për analizimin e Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.04/L-249 për sigurime shëndetësore	13
13.7 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike.....	14
14. Plani i veprimit për vitin 2022.....	14

1. Infrastruktura Juridike

Gjatë këtij tramujori u mbajtën dy (2) mbledhje të kuvendit të OMK-së dhe në një rast u votua elektonikisht.

Me datë 17 janar 2022 u mbajt mbledhja e I-rë e legjislaturës së tretë e Kuvendit të OMK-së. Në këtë mbledhje u zgjedhën:

- Nënkyetarët e OMK-së;
- Anëtarët e Këshillit Drejtues të OMK-së;
- Kryetari , zv.kryetari dhe anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të OMK-së;
- Prokurori dhe zv.Prokurori i OMK-së.

Me datë 28 janar 2022 anëtarët përmes votimit elektornik me shumicë votash, votuan për plotësim-ndryshimin e statutit të OMK-së.

Me datë 16 shkurt 2022 u mbajt mbledhja e II-të (2) e legjislaturës së tretë e Kuvendit të OMK-së. . Në këtë mbledhje u zgjedhën:

- Kryetari, zv.kryetari dhe anëtarët e Gjyqit të Nderit të OMK-së.
- Anëtarët e Komisioneve të Përhershme të OMK-së.

Gjithashtu u marrën disa vendime si në vijim:

- Vendim për caktimin e taksave administrative në OMK-ë;
- Vendim për caktimin e kuotës së antarësisë në OMK-ë;
- Vendim për miratimin e buxhetit të OMK-së për vitin 2022;
- Vendim për autorizimin e Këshillit Drejtues për negocjimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes për bashkëfinancim me Qeverinë e Dukatës së Madhe të Luksemburgut, për ndërtimin e ndërtesës së përbashkët të Odave të Profesionistëve Shëndetësor.

2. Këshilli Drejtues

Në periudhën kohore janar - mars 2022, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur tre (3) takime ku janë shqyrtuar lëndët si më poshtë:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM 1	Vendimet sipas kërkesave/a nkesave të pranuar për periudhën TM 1	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën TM 1	Vendimet për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Këshilli Drejtues i Odës	4	4	0	1- Vendim për zgjedhjen e kryetarit/nënkryetarit të KD-së; 2- Vendim për publikimin e konkursit publik për financimin e 10-të punimeve shkencore; 3- Vendim për përpilimin e komisionit Ad-Hoc për përpilimin e kriterëve të konkursit për punime shkencore; 4- Vendim për themelimin e zyrës për Projekte dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare; 5- Vendim për publikimin e njoftimit për rekrutimin e një Zyrtari të Lartë Ekzekutiv. 6- Vendim për fillimin e procedurave tenderuese për furnizim të OMK-së me faksimila. 7- Vendim për fillimin e procedurave të prokurimit për shpallje të tenderit për furnizim me material shpenzues për zyrën e OMK-së	0

3. Anëtarësimi

Gjatë periudhës kohore janar - mars 2022, në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 160 mjekë, nga të cilët janë 11 mjekë të punësuar në sektorin publik, 13 mjekë të punësuar në sektorin privat, 135 mjekë të papunë dhe 1 mjek në pension.




Tabela 1.1: Anëtarësimet për periudhën kohore janar - mars 2022




Tabela 1.2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri më datën 31 mars 2022

Gjatë kësaj periudhe është ndarë nga jeta 1 mjek si dhe janë rianëtarësuar 14 mjekë, si rezultat numri total i anëtarëve deri me datën 31 mars është 4890 mjekë.


4. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të Odës, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të odës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM 1	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën TM 1	Sanksionet e shqiptuara për periudhën TM 1	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën TM 1	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	13	11	///	///	10	15
Këshilli Etik	6	6	Rekomandime kolegjale 0 Qortim Publik 0 Gjoha:0 Gjithesëj: 0 00.00€	Qortim publik 0 Rekomandime kolegjale 0 Gjoha 0 (0.00€) Gjithesëj: 0 00.00€	5	11
Gjyqi i Nderit	0	0	0	///	0	0
Certifikatat e të kaluarës etike	53	///	///	///	///	///


5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë periudhës janar - mars 2022 ka akredituar 36 aktivitete. Në kuadër të aktiviteteve të akredituara, pesë shoqata kanë bërë kërkesë për përkrahje financiare për organizimin e aktiviteteve, tre nga kërkesat janë refuzuar për përkrahje financiare kurse dy kërkesa janë aprovuar nga Komisioni.



6. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional gjatë periudhës janar - mars 2022, ka lëshuar 692 licenca me kategoritë si në grafikun e mëposhtëm:



7. Edukimi specialistik - zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të

Dizajnimi dhe fillimi i fazës kalimtare të zbërthimit të kompetencave të edukimit specialistik (zbërthimi ligjor, financiar dhe teknik) është në proces e sipër, duke përfshirë edhe hartimin e UA-së për shkollim specialistik.

Por në ndërkohë, bazuar në Nenin 9, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.7, të Ligjit për OPSH-të, si dhe Nenin 72, paragrafi 5, të Ligjit për Shëndetësi, OMK ka kërkuar auditim të procesit pasi që ka konstatuar dhe faktuar një mori shkeljeve ligjore. Procesi i auditimit ka filluar nga ana e MSh-së.

8. Këshilli Mbikëqyrës

Në periudhën kohore janar - mars 2022, Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së ka mbajtur tre takime, ku i kanë shqyrtuar Vendimet e Këshillit Drejtues të OMK-së dhe Raportin Financiar të OMK-së.

9. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Në periudhën kohore janar - mars 2022, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar dhe shqyrtuar gjashtë kërkesa për leje për hulumtim. Të gjashtë kërkesat e parashtruara nga palët janë aprovuar, dhe aplikuesëve u janë lëshuar lejet për hulumtim.

10. Komisioni për Edukim Specialistik

Në periudhën kohore janar - mars 2022, Komisioni për Edukim Specialistik ka mbajtur mbledhjen konstitutive si dhe ka bërë shqyrtimin e infrastrukturës ligjore për kompetencën në pritje të bartjes për edukim specialistik dhe sub-specialistik

11. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke

Në periudhën kohore janar - mars 2022, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke ka pranuar dy kërkesa për përkrahje financiare. Komisioni ka nxjerrë dy vendime pas aprovimit të kërkesave të parashtruara nga palët.

12. Raporti financiar**12.1 Raporti financiar për periudhën deri me 31 mars 2022**

1.0 Të hyrat:		
1.1 Të hyrat e shtyera nga 2021		€ 611,305.00
Total të hyrat e shtyera nga 2021		€ 611,305.00
1.1 Të hyrat	Realizimi: TM1	TOTAL
1.1.1 Të hyrat nga anëtarësia:		
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€ 269,310.00	€ 269,310.00
1.1.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€ 3,050.00	€ 3,050.00
1.1.4 Licencimi	€ 34,825.00	€ 34,825.00
1.1.5 Të hyrat e tjera*	€ 10,805.97	€ 10,805.97
1.1.6 Donacione për ndërtimin e obeliskut në nder të profesionistëve shëndetësor-Projekt i përbashkët i OPSH-ve	€ 1,000.00	€ 1,000.00
1.1.7 Projekti i LuxDEV	€ 84,000.00	€ 84,000.00
Të hyrat deri me 31.03.2022	€ 402,990.97	€ 402,990.97
Të hyrat e shtyera nga 2021		€611,305
TOTAL TË HYRAT		€ 1,014,295.97

2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	TOTAL
2.1 Paga, meditje dhe kontributet pensionale	€ 64,278.43	€ 64,278.43
2.2 Material shpenzues	€ 830.15	€ 830.15
2.3 Reprerentacioni	€ 585.00	€ 585.00
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€ 2,920.00	€ 2,920.00
2.5 Shpenzimet e tjera*	€ 6,699.56	€ 6,699.56
2.6 Shpenzimet e aseteve		€ -
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€ 1,620.00	€ 1,620.00
2.8 Xhirologaria për ndërtimin e obeliskut në nder të profesionistëve shëndetësor-Projekt i përbashkët i OPSH-ve	€ 53,855.86	€ 53,855.86
2.9 Llogari të pagueshme	€ 5,366.00	€ 5,366.00
TOTAL SHPENZIMET 31.03.2022	€ 136,155.00	€ 136,155.00

TOTAL BILANCI	€ 878,140.97
----------------------	---------------------

1.1.5*Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, Regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, Faksimili, Faksimili i dytë, Kongreset, simpoziumet, seminarët, konferenca vendore pa pjesëmarrje ndërkombëtare, aktivitetet e organizuara nga kompanitë farmaceutike, Certifikatës për të kaluarën etike, Lejimi për hulumtime bio-mjekësore për anëtarë të Odës, Të hyrat nga dënimet (masat disiplinore), Dhurata / donacione, Të ardhurat të tjera .

2.5*Faksimili, Anëtarësimi në CPME, Shpenzimet e tel.,Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Pajisje të IT, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit,Shpenzimet e transportit, Inventari, Shpenzimet e tjera operative.

2.7*Tek përkrahja për solidaritet përveq mjeteve të ndara për mjekët të cilët kanë lënguar nga ndonjë sëmundje, janë të përfshira edhe mjetet e ndara për familjet e mjekëve të cilët kanë ndërruar jetë si pasojë e infektimit me virusin COVID19, bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues me nr. Ref. 53/20.

2.8* Në raportin financiar për periudhën derimë 31 dhjetor 2021, janë të përfshira edhe mjetet e menaxhuara nga OMK, të cilat janë në kuadër të projektit të përbashkët të Odave të Profesionistëve Shëndetësor, për ndërtimin e obeliskut "Për Jetën" kushtuar veprës dhe sakrificës së profesionistëve shëndetësor ndër dekada. Qëllimi i këtij njoftimi është se mjetet e bartur nuk janë pasuri e Odës së Mjekëve, por janë mjete të projektit i cili vazhdon edhe në vitin 2022.

12.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Oda e Mjekëve të Kosovës gjatë periudhës janar - mars 2022 ka akorduar përkrahje financiare për,

- Shoqatën e Nefrologëve të Kosovës për organizimin e kongresit “Dita botërore e veshkës”, me vlerë 1,500.00 €
- Asociacionin e Psikiatërve të Kosovës për organizimin e “Programit vjetor të EVM-së për profesionistët e Shëndetit Mendor Maj-Qershor 2022” me vlerë 2,240.00 €

12.3 Prokurimi

Gjatë periudhës kohore janar - mars 2022 u zhvilluan dy procedura të hapura të prokurimit

Në muajin janar u zhvillua procedura me vlera të vogla për organizimin dhe mbajtjen e mbledhjes së kuvendit të OMK-së legjislatura e II. Procedura e prokurimit u zhvillua me sukses dhe branda afatit u lidh kontrata me operatorin ekonomik.

Në muajin shkurt u zhvillua procedura e hapur e prokurimit “Furnizimin me faksimil për anëtarët e OMK-së”. Si rezultat i kësaj ftese janë pranuar ofertë nga katër operator ekonomik, ku përzgjedhja e operatorit ekonomik u bë sipas konformitet cilësor të shërbimit të ofruar, duke u mbështetur në arsyeshmërin e çmimit të ofruar dhe pasi që operatori ekonomik ka plotësuar të gjitha kërkesat në përputhshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit.

13. Aktivitete të tjera

13.1 Botimi i Revistës Mjeku

Gjatë periudhës janar - mars, u publikua numri i parë i vëllimit të dytë i “Revista Mjeku”.

Në muajin Mars u bë publikimi i Revistës Mjeku, me temë bosht “Sëmundjet Kardiovaskulare”. Revista përmban 23 artikuj, të përmbledhura në 57 faqe. Artikujt e këtij numri prezantojnë aspekte të ndryshme të Sëmundjeve Kardiovaskulare në shtetin tonë, aktualitete në OMK dhe artikuj të tjerë relevant dhe cilësor.

Revista është publikuar online në faqen e Odës së Mjekëve të Kosovës, në mënyrë që të arrijë audiencë sa më të gjerë (linku: [Revista Mjeku – SËMUNDJET KARDIOVASKULARE](#)).

13.2 Kongresi i tretë të Mjekësisë me temë Pandemia COVID-19, Sfidat dhe Përvojat

Organizimi i Kongresit të tretë të Mjekësisë me temë Pandemia COVID-19, Sfidat dhe Përvojat, kishte filluar në muajin korrik 2021 dhe ka qenë i planifikuar të organizohet në muajin nëntor 2021. Gjatë muajit tetor Këshilli Organizativ I kongresit ka analizuar të gjithë faktorët ndikues dhe duke u bazuar edhe në situatën epidemiologjike me COVID-19 në Kosovë, sidomos përkeqësimit të gjendjes gjatë muajve korrik -shtator dhe rekomandimit të Këshillit Shkencor sepse janë dorëzuar numër i pamjaftueshëm i abstrakteve për Kongres, vendosi që Kongresi i tretë mjekësor, Pandemia Covid-19 Sfidat dhe Përvojat, të shtyhet për një kohë të caktuar dhe i njëjti të mbahet në vitin 2022.

Organizimi i kongresit filloj në muajin shkurt 2022 dhe data për mbajtjen e kongresit u caktua 02-04 Qershor 2022. Pasi që gjendja me pandeminë gjatë vitit 2022 është përmirësuar u vendos që kongresi të mbahet me pjesëmarrje fizike.

Kongresi do të zhvilloj punimet në sesione sipas këtyre temave:

- Shëndeti Publik dhe Menaxhimi i Pandemisë COVID-19;
- Menaxhimi Ambulantor dhe Klinik i COVID-19;
- Shëndeti Mendor dhe COVID-19;
- Të tjera.

13.3 Obelisk kushtuar punëtorëve shëndetësor

Me datë 16 shkurt në hyrjen e QKUK-së u bë inagurimi i monumentit përkujtimor-Obelisk.

Pjesëmarrës në këtë inagurim ishin Ministri i Shëndetësisë Dr. Rifat Latifi, kryetari i Komunës së Prishtinës, z. Përparim Rama, kryetari i Odës së Mjekëve, Dr. Pleurat Sejdiu, kryetari i Odës së Infermierëve, z. Naser Rrustemaj, kryetari i Odës së Farmacistëve, Prof. Dr. Arianit Jakupi, kryetari i Odës së Stomatologëve, Prof. Dr. Blerim Kamberi dhe pjesëmarrës të tjerë të institucioneve shëndetësore të Republikës së Kosovës.

Iniciativa për ngritjen e një obelisku në nderim të punës dhe sakrifices së punëtorëve shëndetësorë, u ndërmor nga vet Kryetari i OMK-së, qysh në Tetor 2020. Pas dhënies së mbështetjes për një iniciativë të tillë nga ana e Këshillit Drejtues të OMK-së, u është bërë ftesë për bashkëpunim dhe përkrahje edhe Odave tjera të Profesionistëve Shëndetësor, e të cilat kanë shprehur gadishmërinë për bashkëorganizim dhe bashkëfinancim për realizimin e këtij projekti.

Ky monument do nderoj sakrificat ndër dekada të punëtorëve shëndetësorë, si në periudhën e helmimit të nxënësve dhe përkujdesjen e të plagosurve të demonstartave gjithëpopullore të viteve '80-të, atëherë në vitet e 90-ta kur regjimi i kohës i hodhi në rrugë, ata në mënyrë të organizuar përmes shoqatës “Nëna Terezë”; Lufta e UÇK-së dhe tani lufta e fundit me COVID-19.

Ky monument u realizua nga Odat e Profesionistëve Shëndetësor me përkrahjen e ministrit të shëndetësisë, kryetarit të Prishtinës, asamblenë Komunale dhe donatorë të ndryshëm.

Gjithashtu me datë 16 shkurt Odat e Profesionistëve Shëndetësor morrën vendim që kjo datë të shpallet ditë Përkujtimore e profesionistëve shëndetësor në Republikën e Kosovës.

13.4 Tryeza e rrumbullakët - “Gjendja aktuale në sektorin e shëndetësisë – Kemi apo nuk kemi sistem shëndetësor funksional? Kahja e reformës së nevojshme”

Me datë 24 shkurt 2021 u mbajt Tryeza e rrumbullakët me temën “Gjendja aktuale në sektorin e shëndetësisë – Kemi apo nuk kemi sistem shëndetësor funksional? Kahja e reformës së nevojshme”.

Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin Ministri i shëndetësisë, Dr. Rifat Latifi, Kryetari i Odës së Mjekëve, Dr. Pleurat Sejdiu dhe përfaqësues nga Rektorati i Unisversitetit të Prishtinës, Përfaqësues nga dekanati i Fakultetit të Mjekësisë, Kryetarët e OPSH-ve, Përfaqësues të projektit Lux-Dev etj.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte prezantimi i çështjeve problematike të sistemit tonë shëndetësor.

Në këtë tryezë u përmendën pikat si Hartimi i politikave dhe strategjive duke theksuar se është mëse i nevojshëm në sistemin tonë shëndetësor, ndalimin e ikjes së mjekëve nga vendi duhet ta bëjmë duke përmirësuar kushtet e vendeve të punës, sigurimet shëndetësore, financimin, matja e performancës, nivelin terciar, sistemi i informimit etj.

Nga ministria e shëndetësisë janë përcaktuar 7 shtylla që duhet të fokusuar në 10 vitet e ardhshme e tutje, një më kryesoret është cilësuar edukimi specializantëve.

Dr. Sejdiu ftoi dhe inkurajoi pjesëmarrësit për diskutimin dhe zgjidhjen e këtyre problematikave.

13.5 Marrëveshja për bashkëfinancimin e projektit të profilizimit të mjekëve - trajnimeve për stafin e Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit

Oda e Mjekëve të Kosovës dhe projekti Lux Dev nënshkruan marrëveshjen për bashkëfinancimin e projektit të profilizimit të mjekëve- Trajnime specifike jashtë vendit

Për shkak të besimit të treguar përgjatë bashkëpunimit shumëvjeçar mes Odës dhe projektit të mbështetur financiarisht nga qeveria e Luksemburgut dhe Kosovës (projekti KSV/017), dhe duke pas parasysh kredibilitetin dhe profesionalizmin e Odës së Mjekëve të Kosovës në kryerjen e funksioneve publike, është nënshkruar marrëveshja e mirekuptimit mes Odës së Mjekëve të Kosovës dhe projektit Lux Dev.

Projekti ka alokuar një vlerë prej 120,000.00€ për implementimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve të Odës, si dhe mbështetjen për organizimin të trajnimeve profesionale-profilizimeve për një numër të përzgjedhur të mjekëve nga spitalet e përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit.

Me datë 25 mars u nënshkruan Marrëveshjet për financim të trajnimeve mes OMK-së dhe Spitaleve të Gjilanit e Prizrenit.

Marrëveshja ka të bëjë me zbatimin e aktiviteteve të programit për trajnimin dhe zhvillimin profesional të mjekëve të spitaleve përkatëse. Program i cili është hartuar mbi planin e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën 2022-2026 dhe përmes këtyre trajnimeve mjekët e këtyre spitaleve do të kenë mundësi të ngrisin shkathtësitë dhe njohuritë e tyre në aspektin profesional.

13.6 Grupi punues për për analizimin e Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.04/L-249 për sigurime shëndetësore

Qëllimi i grupit punues është analizimi i draftit të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-249 për Sigurim Shëndetësor dhe nxjerrja e propozime konkrete për plotësim ose ndryshim.

Anatarët e grupit punues në takimet e mbajtura diskutuan lidhur me parimet e përgjithshme të përpilimit të akteve juridike në përgjithësi. Gjatë punës po bëjnë edhe analizimin e Ligjit për Sigurime Shëndetësore të vendeve të Ballkanit, dhe pastaj do të jepen propozimet më të mira të mundshme, për tu inkorporuar në Ligjin tonë.

13.7 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së, Prokurori i OMK-së, Gjykatat Themelore ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën janar-mars	Vendimet sipas urdhëresave/kërkesave të pranuar për periudhën janar-mars	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën janar-mars	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprahe
Kryetari i Odës	2	2	2	0	0

14. Plani i veprimit për vitin 2022

Projektet afatmesme dhe afatgjata

- Projekti për ndërtimin e një objekti për të gjitha OPSH-të mbështetur nga MSH-ja, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë”. Kësaj iniciative i janë përgjigjur të gjitha OPSH-të dhe kërkesa zyrtare për mbështetje është nënshkruar nga të gjitha ato dhe më pas është dorëzuar në MSH. Fillimi i ndërtimit pritet pas dhënjes së përlqimit nga ana e ShSKUK-së dhe MSh-së për parcelën për ndërtim.
- Pas miratimit të kërkesës nga OMK drejtuar LuxDev-it lidhur me përkrahjen financiare për zhvillimin e sistemit informativ/bazës interaktive të të dhënave, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Kohëzgjatja e projektit është 1 vit.
- Zbërthimi dhe bartja e kompetencave për edukimin specialistik bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të.
- Botimi i numrave në vazhdimësi të “Revistës Mjeku”
- Organizimi i Kongresit të III multidisiplinar me fokus COVID-19
- Organizimi i Kongresit të IV multidisiplinar me fokus diabetin